



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr : 04-353/01-78856

Data: 14.08.2025

Prizren

DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSIOR KK – PRIZREN, me kërkesën e Shatri Invest SHPK posedues Hezer,Hamdi,Elesa , Ilijaz Shatri dhe Shatri Invest SHPK në rrugën “Brigada 125” pn., me të cilën ka kërkuar leje për - gropim/ kyqje për infrastrukture me kablo energjetike, kanalit, vendosjen e pusetave energjetike dhe Trafostacionit Sn=1000kVA10(20)/0.4kv, në bazë të nenit 3 paragrafi 1 pika 1.1, 1.4, 1.24, si dhe nenit 5, paragrafit 1.1 e lidhur me nenit 15 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit për Ndërtim numër 04/L-110, nenit 3 të Ligjit për Planifikim Hapsinor dhe sipas Vendimit për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit (HZK) për periudhën 2022 – 2030 – Numër 001-011-48192 të datës 31. 03. 2022 si dhe konform nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 44, 46, 47, 48 dhe nenit 125 të L.P.P.A numër 05/031 të datës 25. 05. 2016 si dhe neni 142 paragrafi 3 vendimit Komunal për Rregullimin e qytetit dhe të shërbimeve komunale numër 01/011-2 data 18. 11. 2004 merr këtë:

AKTVENDIM

I LEJOHET: Shatri Invest SHPK posedues Hezer,Hamdi,Elesa , Ilijaz Shatri dhe Shatri Invest SHPK në rrugën “Brigada 125” pn., me të cilën ka kërkuar leje për - gropim/ kyqje për infrastrukture me kablo energjetike, kanalit, vendosjen e pusetave energjetike dhe Trafostacionit Sn=1000kVA10(20)/0.4kv (sipas skicës së gjeodetit nr.113 A.Gashi) në ngastra kadastrale 08658-9, 08658-10, 08658-11, 08658-12, 08658-13, 08658-14, 08658-15, 08658-3 dhe PSH.Rruget 11014-0 Z.K.Prizren.

Datën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë inspektionin komunal në afat prej 8 ditësh.

- I.** Vendosja e infrastruktures të bëhet sipas dokumentacioni teknik. me të cilat janë definuar parcelat në aktvendim.
- II.** Te gjitha problemet pronesore juridike në përgjegjësi të mbeten vetë investitorit

- Investitori është i obliguar që punimet të kryen në bazë të dokumentacioni teknik-projektë e në pajtim me normat ndërtimore dhe rregullave teknike për kësi llojë punime.

Kjo Leje bazohet në shqyrtimin e provave:

- Informate pëlqim/zgjidhje nga KEDS NR. .tik.1978049,Nr.587 të dt.11.08.2025
- Sipas pëlqimit të Drejtorisë Shërbimeve Publike Nr. 05-343/01-101548 të dt.05.08.2025
- Sipas pëlqimit Hidroregjioni Jugor Nr. 86673 të dt.04.08.2025
- Sipas pëlqimit PTK Vala me nr.200/2025 të dt.05.08.2025.
- Të përmbahen të gjitha pëlqimet e cilat janë të shkruara që ekzekutimi i punimeve të bëhet me kujdes me njoftime të cekura në keto pëlqime.

III. Investitori është i obliguar që punimet rreth infrastrukture teknike të kryen sipas Aktvendimit të dhëna, kurse vend punimi natën të ndriqohet me dritë ashtu që të mundësohet qarkullimi i lirë i automjeteve dhe të këmbësorëve, kurse materialet të tjera duhet të menjanohen nga rruga ku janë kryer punimet.

IV. Ky aktvendim pushon të vlejë në rastë se me punë nuk fillohet mbrenda afatit prej 12(dymbdhjetë) muajsh,duke llogaritur nga dita e marjes së të njëjtës

V. Pas kryerjes së punimeve Investitori është i obliguar që vendin menjëherë të bjerë në gjendje të mëparshme dhe cdo dëmtim obligimi mbetet investitorit.

VI. Në qoftëse punimet në infrastrukture nuk mund të kryen në afatin e lejuar, Investitori është i obliguar që të kërkoj nga ky organ leje për vazhdimin e afatit të punimeve.

A r s y e t i m

Shatri Invest SHPK posedues Hezer,Hamdi,Elesa , Ilijaz Shatri dhe Shatri Invest SHPK në rrugën “Brigada 125” pn., me të cilën ka kërkuar leje per - gropim/ kyqje per infrastrukture me kablo energjetike, kanalit, vendosjen e pusetave energjetike dhe Trafostacionit Sn=1000kVA10(20)/0.4kv (sipas skicës se gjeodetit nr.113 A.Gashi)ne ngastra kadastrale 08658-9, 08658-10, 08658-11, 08658-12, 08658-13, 08658-14, 08658-15, 08658-3 dhe PSH.Rruget 11014-0 Z.K.Prizren

Duke shqyrtuar kërkesën e Investitorit si dhe dokumentacionit teknik dhe të shtojcave tjera të prezentuara s’bashku me kërkesë vërtetohet se:

Në proceduren paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunëtorit profesional.

Në kuptim të dispozitave të lartë theksuara është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhënien e lejes për vendosje - gropim/ kyqje per infrastrukture me kablo energjetike, kanalit, vendosjen e pusetave energjetike dhe Trafostacionit Sn=1000kVA10(20)/0.4kv Nga se u tha më lartë uvendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marjes së të njëjtës Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor-Prishtinë.


Ankesa taksohet me 0,50 Euro taksa administrative.

Bashkëpunëtor profesional:



Zana Belloda, inxh. dip. ark.

DREJTORI:



Pranverim Berisha, jur. dip.